



MJEDISI JETËSOR EUROPIAN GJENDJA DHE PERSPEKTIVAT 2015

Vlerësimi integral i mjedisit jetësor europian



Raporti i "Mjedisit jetësor europian- gjendja dhe perspektivat 2015" (SOER 2015) jep një vlerësim gjithpërfshirës të gjendjes së mjedisit jetësor europian, trendeve dhe perspektivave dhe e vendos të njëjtin në kontekst global. Ai siguron informata për zbatimin e politikës europiane të mjedisit jetësor midis viteve "2015 dhe 2020 dhe i analizon mundësitë për ndryshimin e politikave aktuale (dhe njohuritë të përdorura si mbështetje të këtyre politikave) me qëllim që të realizohet vizioni i Bashkimit europian për jetë të mire në kuadër të kufizimit të planetit.

SOER 2015 është i bazuar në informata objektive, të sigurta dhe krahasuese për mjedisin jetësor dhe mbështetet në bazë të dëshmive dhe njohurive të EEA dhe Rrjetit europian për informim për mjedisin jetësor dhe përcjelljen e të njëjtit (Eionet), rrjetit të 39 shteteve europiane .

Me diapazonin e vet të gjerë të informacioneve globale, europiane, rajonale dhe nacionale, të plotësuar me raport sintetizues dhe raport për trendet mega globale, SOER 2015 paraqet burim të çmueshëm të njohurive për të gjithë ata që janë të interesuar për mjedisin jetësor të Europës dhe që janë të përfshirë në përmirësimin e tij.

SOER 2015 do të shpallet më 3 mars 2015.

eea.europa.eu/soer

SOER 2015 Raporti sintetizues

Me këtë raport, në përgjithësi do të mbështetet politika e mjedisit jetësor e Europës, sidomos zbatimi i saj midis viteve 2015 dhe 2020. Ai përmbanë recension për mjedisin jetësor europian në korniza globale si dhe kapituj , në të cilët janë sublimuar gjendja e mjedisit jetësor në Europë, trendet në të njëjtin dhe perspektivat e tij.

SOER 2015 Vlerësimi i trendeve mega globale

Raporti për trendet mega globale vlerëson 11 trende- mega me rënësi për mjedisin jetësor të Europës në afat të gjatë. Gjatë vlerësimit të shtysave kyçe, trendeve dhe implikimeve për Europën, ai përpiqet të sigurojë bazë më të mirë për krijimin strategjik europian të politikës për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Trendet mega -globale	Informata të shkurtra europiane	Krahasime midis shteteve	Shtete dhe rajone
11 informata të shkurtra për : <ul style="list-style-type: none">• Ndryshimi i trendeve populuese globale• Drejt një bote më urbane• Ndryshimi i ngarkesave me sëmurje dhe me rreziqe për pandemi• Përshpejtimi i ndryshimit teknologjik• Rritja e mëtutjeshme ekonomike ?• Botë gjithnjë më e popullarizuar• Konkurrencë e forcuar globale për resurse• Trysni të shtuara të ekosistemeve• Pasoja gjithnjë e më serioze nga ndryshimet klimatike• Ndotje gjithnjë e më e madhe e mjedisit jetësor• Shumëllojshmëri e qasjeve	25 informata të shkurtra tematike për: <ul style="list-style-type: none">• Bujqësi• Ndotje të ajrit• Shumëllojshmëri biologjike• Pasojar nga ndryshimet klimatike dhe adaptimi në to• Konsumi• Energjetika• Pyjet• Cilësia e ujërave të ëmbla• Ekonomia e gjelbër• Shëndeti dhe mjedisi jetësor• Sistemet hidrologjike dhe menaxhimi i qëndrueshëm me ujërat• Industria• Sistemet e tokës• Mjedisi detar• Aktivitetet detare• Zbutja e ndryshimeve klimatike• Kapitali natyror dhe shërbimet e ekosistemit• Zhurma• Efikasiteti i resurseve• Toka• Ajri dhe ndryshimet klimatike• Turizmi• Transporti• Sistemet urbane• Mbeturinat.	9 informata të shkurtra për: <ul style="list-style-type: none">• Bujqësia – prodhimi organik• Ndotja e ajrit –emisioni i materieve të zgjedhura ndotëse• Llojlojshmëria biologjike-zonat e mbrojtura• Energjetika- konsumi i energjisë dhe pjesëmarrja e energjisë së përtëritshme• Cilësia e ujërave të ëmbla – nutrientë• Zbutja e ndryshimeve klimatike-emisioni i gazrave serrë• Efikasiteti i resurseve• –efikasiteti i i materialeve dhe produktiviteti• Transporti-kërkesa për transport të udhëtarëve dhe modeleve• Mbeturina-krijimi dhe menaxhimi i mbeturinave të forta komunale <p>Këto krahasime janë të bazuara në indikatorët për mjedisin jetësor bashkërisht për shumë shtete europiane dhe të lidhura me informatat dhe indikatorët në nivel</p>	39 informata të shkurtra, të cilat i sublimojnë informatat për gjendjen e mjedisit jetësor në: <ul style="list-style-type: none">• 33 shtete anëtare të EEA• 6 shtete bashkëpunëtoresh të Ballkanit Perëndimor <p>Në mënyrë plotësuese, 3 informata të shkurtra japin pasqyrë për sfidat kryesore në mjedisin jetësor në rajone të zgjedhura që shtrihen jashtë Europës , të identifikuar në programin e 7-të aksional për mjedisin jetësor të Bashkimit Europian</p> <ul style="list-style-type: none">• Rajon arktik• Rajoni i Detit të Zi• Rajoni i Detit mesdhe

Të gjitha informatat e lartpërmendura do të jenë të disponueshme në internet deri më 3 mars 2015: eea.europa.eu/soer.

Versionet e shtypura mund të porositen përmes shërbimit për parapagim të EEA: eea-subscriptions.eu/subscribe.

Raporti Mjedisi jetësor europian – gjendja dhe perspektivat 2015, është përgatitur si aktivitet i përbashkët në bashkëpunim të ngushtë me 33 shtete anëtare dhe 6 shtete bashkëpunëtoresh të EEA, si dhe shërbimet e Komisionit europian. Në mënyrë plotësuese, në procesin e revizionit profesional të vlerësimit pa u përfshirë disa organizata ndërkombëtare.

Agjencia europiane e mjedisit jetësor (EEA) është agjenci e Bashkimit europian. Qëllimi i saj është ta mbështes zhvillimin e qëndrueshëm dhe të ndihmojë në arritjen e informatave të sigurta, relevante, qëllimore dhe në kohë për krijuesit e politikës dhe për publikun. Për më shumë informata shikoni në: eea.europa.eu.